



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 230, Datë 26.10.2018

MBI

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SGD
ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ENERGJISË
NGA HEC “NDËRFUSHAS” ME FUQI TE INSTALUAR 1125 KW, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN E BULQIZËS**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma” a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5 pika 1, gërma “a”; nenit 8, pika 2 dhe nenit 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19, pika 1, gërma ”a” të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas” me fuqi të instaluar 1125 kW, dhe vendndodhje në zonën e Bulqizës.

Konstatoi se:

- Shoqëria “SGD Energji” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 655 Prot, datë 17.10.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kW, dhe vendndodhje në zonën e Bulqizës për një periudhë 49 vjeçare.
- Aplikimi i shoqërisë “SGD Energji” shpk, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”), Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) Plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni i munguar ka të bëjë me:

- Vërtetimet nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, gërma “d”);
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave); “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit); “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe “d” (vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s).
- Mungesa e kryerjes së pagesës së aplikimit për licencim përbën një element thelbësor për mosfillimin e procedurës së licencimit.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SGD ENERGJI” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ndërfushas” me fuqi 1125 kW, me vendndodhje në zonën e Bulqizës.
2. Subjekti mund të paraqesë brenda 30 ditëve një aplikim të ri sipas nenit 10, pika 7 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

KRYETARI

PETRIT AHMETI